



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 24075 prot.

Shkodër, me 20 . 11 .2025

N J O F T I M

Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër”, miratuar me Vendimin Nr.60, datë 28.12.2020, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak ditën **e Enjte** datë **27.11.2025 ora 17:00** , me rend dite si më poshtë:

Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 31.10.2025 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2.

1. *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Tetor 2025”.*
2. *Projektvendim: “Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak, Z.Sead Jusha”.*
3. *Projektvendim: “Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares bashkiake Znj.Bledianë Osja”.*
4. *Projektvendim: “Për miratimin e planit të lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane për Shkodrën ”.*
5. *Projektvendim: “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2025 “Për Taksat dhe Tarifat vendore në Bashkinë Shkodër ”, i ndryshuar*

6. *Projektvendim: "Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore" "Rosek Drisht" dhe "Drin Gjadër Kir", Bashkia Shkodër*
7. *Projektvendim: "Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga Fondi Pyjor Kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private të Z. Ded Kaci, zhvillues shoqëria "Star Plus" shpk brenda territorit të Bashkisë Shkodër".*
8. *Projektvendim: "Për miratimin e zbatimit të projektit Arti për Europën (ARTE), në kuadër të programit CERV - Network of Town".*
9. *Projektvendim: "Për një ndryshim në VKB nr.69, datë 30.10.2017 "Pë miratimin e memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe metodologjinë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile".*
10. *Projektvendim: "Për strehim emergjent të familjes L.Selja dhe T.Gomila në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë ish Konviktit të Veterinares".*
11. *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".*
12. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve

Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1.	Komisioni i Mandateve dhe Rregullores	E Premte	21.11.2025	10:00
2.	Komisioni i Shërbimeve Sociale dhe Strehimit	E Martë	25.11.2025	10:00
3.	Komisioni i Çështjeve Ligjore.	E Martë	25.11.2025	10:30
4.	Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve dhe Manaxhimit të Ujërave Dhe Mbrojtjes së Mjedisit	E Martë	25.11.2025	11:00
5.	Komisioni i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike / Komisioni i Kontrollit Financiar	E Martë	25.11.2025	12:00
6.	Komisioni i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	E Martë	25.11.2025	12:30

Duke Ju falënderuar,

